

**MEMORY, FORGETFULNESS AND THE OTHER IN THE POETRY
WORK OF LINDITA AHMETI
KUJTESA, HARRESA DHE TJETRI NË KRIJIMTARINË E LINDITA
AHMETIT**

Kaltrina SADIKU¹

¹ *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: kaltrina.sadiku@unite.edu.mk*

Në krijimtarinë e Lindita Ahmetit përmes miteve shprehet brenga e autores për gjumin e harresës në të cilin ka rënë populli i saj, bëhet thirrje për kujtesë dhe kujtohet tjetri, i ndryshmi nga kombi i cili i shkakton vuajtje e tmerre njeriut të saj, që i bën padrejtësi pafund dhe shkel mbi kombin e saj si mbi zemrën e saj duke lënë pas plagë, tmerr e dhunë. Për të studiuar këtë temë do të përdoret metoda e analizës.

Mite e zota antikë marrin rolin e thirrjes në kujtesë dhe e ndihin Lindita Ahmetin t'i japë kushtim zërit të saj, ndërhyjnë në realitetin tonë, bëhen për ne udhëtrëgues, bëhen për ne paralajmërim për fatin që na pret nëse harrojmë vetveten, nëse nuk e kujtojmë vetveten, kulturën dhe identitetin tonë. Të njëjtët bëhen simbole të shpresës e rezistencës, na ndihin të personifikojmë tmerrin e përjetuar nga tjetri, i ndryshmi nga ne, që nuk mund të pranojë të vërtetën historike, që s'duron dot kulturën tonë si të mëvetësishme; tjetri që tenton t'i përvetësojë vlerat tona a t'i mohojë ato, që lufton gjuhën tonë dhe gjenin tonë.

I. Kujtesa - Poetja bën thirrje për kujtesë përmes disa poezive në disa nga veprat e saj duke përdorur figura të ndryshme mitologjike.

1. Mnemozina¹⁶⁹ - Thirrje për kujtesë shohim që poetja nuk mund të mos bënte përmes parëndeshës së kujtesës Mnemozinës. Poetja në vepra i flet dhe i lutet Mnemozinës, merr nga dija e saj dhe ia shpalosë atë lexuesit. Ajo dëshiron ta mbajë gjallë kujtesën për të kaluarën

¹⁶⁹ Perëndesha Mnemozinë, personifikim i "Kujtesës", motra e Kronosit dhe Oqeanit, është mëma e Muzave. Ajo është e gjithëdijshme: sipas Hesiodit, ajo di "gjithçka që ka qenë që është dhe që do të jetë". Kur poeti është i pushtuar nga muzat ai merr drejtpërsëdrejti nga dija e Mnemozinës, me një fjalë nga dija e "originës", "zanafillës" së gjenealogjive. "Muzat i këndojnë, duke ia nisur nga fillimi- ex arkhes buthtimit të kryehershëm të botës, gjenezës së perëndive, lindjes së njerëzimit. E shpalosur kësisoj, e shkuara është më tepër sesa thjesht një pararendëse e së tashmes: ajo është burimi i saj. Duke u kthyer nga prapa ndërmenda nuk rreket t'i vendosë ngjarjet në një kornizë kohore, porse të arrijë prej thellësitë e qenies, të zbulojë origjinalitetin, realitetin e kryehershëm prej nga u shkrodh kozmosi, atë që na lejon ta rrokim krijimin si një të tërë. (Eliade, Mircea, *Miti dhe realiteti*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2019, fq. 118).

historike të kombit të saj, sepse siç thotë Eliade¹⁷⁰ “për aq kohë sa është “e harruar”, “e shkuara”,- historike a priomidale qoftë- përqaset me vdekjen. Siç kuptojmë autorja i druhet vdekjes së kulturës e gjuhës së kombit të saj e me këtë i druhet zhdukjes së kombit. Prandaj thirrja për kujtesë bëhet e fuqishme dhe kushtruese në krijimtarinë e poetes.

Në veprën “*Mëshateknaja e babait*” mitin mbi Mnemozinën e gjejmë te “*Bari i tamblit*”¹⁷¹ ku ajo bashkë me muzën e presin subjektin lirik në sofrën e miqësisë dhe i rrinë pranë subjektit lirik kur ajo e sodit Hermesin që i jep forcë hyjnore barit të tamblit të bulojë, atëherë kur marsi i pengon lulet e barit të tamblit. Mnemozina tronditet bashkë me subjektin lirik, kur godet rrëmeti e rrëmuja dhe kur sërish del ylberi, kur nëna e thërret subjektin lirik dhe e këshillon atë të bëhet e dëgjueshme e të kthehet pranë të ëmës në kullë. Mnemozina ia hap subjektit lirik frëngjitë e kullës dhe i thotë se koha është dhe se tashmë ka ardhur prilli dhe ajo mund ta shohë baletin e eolit me fijet e barit të tamblit dhe të çmallet.

Siç mund të shihet miti mbi Mnemozinën rimerret për të na porositur që është e rëndësishme të kujtojmë kush jemi e nga rrjedhim edhe në kohërat me rrëmuje e rrëmet edhe në kohërat e mira. Të kujtojmë kush jemi edhe kur jemi afër mikut edhe kur jemi përballë armikut. Njësoj kjo ndodh edhe në poezinë “*Një shportë pa fruta*”¹⁷² të veprës “*Ishulli adular*” subjekti lirik ndjen se edhe Mnemozina ka ikur prej saj, në dhomë të saj nuk ka mbetur më as tavolinë as libra e vargjet e saj edhe i pari i fshatit nuk i merr parasysh fare.

Përmes figurës së Mnemozinës kuptojmë rëndësinë e kujtesës, rëndësinë e vargjeve në të cilat rruhet historia, përjetimet e kultura e një populli. Pra, rëndësinë e vjershave si mjet për ruajtjen e kujtesës së popullit, edhe atëherë kur të gjitha provat materiale që na mundësojnë të kujtojmë të mos jenë më. Mirëpo figura e Mnemozinës në krijimtarinë e Linditës, nuk rimerret vetëm për të folur për nevojën e popullit a individit për të kujtuar veten dhe identitetin e tij, por edhe në disa kuptime të tjera.

Për shembull në poezinë “*Mbille një lule syshkruari im*” të veprës “*Ishulli adular*”¹⁷³ subjekti lirik shpreson që Mnemozina t’ia kujtojë çunit syshkruar fjalën e dhënë, borxhin që i ka- ta mbjellë një lule në oazë, ta lërë një grimë margaritari në shtëpinë pas haraçit dhe ta nxjerrë nga kulla dorën në dritare me fenerin lartë. Pra miti mbi Mnemozinën rimerret për ta përcjellë mesazhin e subjektit lirik drejt çunit syshkruar, për t’i thënë atij se e kishte për borxh ta kujtonte dhe ta linte një shenjë që nuk e kishte shuar kujtimin për të, shpresën. Duke na lënë të kuptojmë që kujtesa e ushqen dashurinë, e mban gjallë atë dhe shpresën.

2. Hermes¹⁷⁴-biri i Zeusit, perëndia e fuqishme e natyrës, lajmëtari i perëndive është figura tjetër e rëndësishme përmes së cilës Lindita bën thirrje për kujtesë. Në veprën “*Mëshateknaja e babait*” në poezinë “*Melia*”¹⁷⁵ ai u tregon të tjerëve gjurmët që duhet të ndjekin në udhën e mundimshme të zbulimit të kuptimit të vërtetë të fjalëve, vjetërsisë së tyre përmes ngjyrës së zanoreve, tenton ta çlirojë nga myshku e lëmashku palimpsestin ku janë shkruar toponimet, bën thirrje të zbulohen kuptimet e thella të fjalëve që kanë mbetur jashtë fjalorit, të asaj gjuhe të zjarrtë që i ka fjalët si lule iris illyrica. Hermes ia del kur toponimet i thonë emrat e vet burimorë në liri dhe në gjurmët e Hermesit dalin plot pjalm shkronjat shqipe të argjendta të cilat ngjiten malit përpyjet e i mundësojnë Melias të marrë udhën drejt Dodonës.

¹⁷⁰ Eliade, Mircea, *Miti dhe realiteti*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2019, fq. 118.

¹⁷¹ Ahmeti, Lindita, *Mëshateknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, fq. 109.

¹⁷² Ahmeti, Lindita, *Ishulli adular*, Shkupi, Shkup, 1996, fq. 146.

¹⁷³ Ahmeti, Lindita, *Ishulli adular*, Shkupi, Shkup, 1996, fq. 140.

¹⁷⁴ Hermes- një nga perënditë më të vjetra të Greqisë, biri i Zeusit dhe i Plejadës. Në fillim ishte perëndi mbrojtës i natyrës, më vonë u bë perëndi e kopeve, mbrojtës i barinjve. Nganjëherë e paraqisnin me një dash në dorë. Në epokën homerike Hermes ishte para së gjithash lajmëtari i perëndive që përmbushte porosinë e ndryshme të Zeusit, ishte gjithashtu përcjellës i shpirtave të të vdekurve në mbretërinë e nëntokës. Hermes quhej si mbrojtës i udhëtarëve. Me zhvillimin e tregtisë ai u bë perëndi mbrojtëse e tregtisë dhe për pasojë e njerëzve të shkathët, të gënjeshtarëve e madje edhe të vjedhësve. (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq.112).

¹⁷⁵ Ahmeti, Lindita, *Mëshateknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, fq. 46.

Miti mbi Hermesin siç mund të kuptohet rimerret për të vënë në pah lashtësinë e gjuhës dhe kulturës shqipe. Hermesin është thirrje për kujtesë, bëhet treguesi i rrugës së zbulimit të thesarit gjuhësor dhe kulturor të lënë pas dore, thirrje për vetëdije, thirrje për zgjim kombëtar. Në po të njëjtën vepër në poezinë **“Anija e varur prej reje”**¹⁷⁶ udhëtarët brenda anijes prej reje rijne të qetë në të dhe qeshin edhe kur mojra Atropë dëshiron ta presë me gërshërët e saj të gjatë fijen ku rri varur anija prej reje dhe t’i dorëzojë ato në duar të Hermesit. Ata banorë që pleq e të rinj nuk i ndejnë goditjet që ju jep Poseidoni as tredhëmbëshin e tij mbi lëkurë, të cilëve u pengon piktura e piktori nuk i pengon koha e cila ikën e shkon shpejtë, nuk u pengon që bujqit e huaj hapin vazhdimisht vrima të mëdha në murin e bardhë të altarit ku rruhet rrënja e artë dhe ku subjekti lirik vajton për njerëzit e driadat që vdesin vazhdimisht sepse thellë në pyll ka hyrë dikush që i pret drunjtë e i lejon vetmisë të shtrijë pushtetin e vet kudo.

Siç mund të kuptohet miti mbi Hermesin rimerret për të folur për vdekjen e ngadaltë që i kanoset kombit shqiptar. Sepse shqiptarët e ngratë nuk trazohen fare për vendin e gjendjen e tyre, nuk e luftojnë armikun që e kanë ndër sy, që iu bën dëm ndër sy, i shkatërron dhe ua vjedh vlerat, heronjtë e kulturën. E ata nuk trazohen fare që t’i dalin zot kulturës së tyre, gjuhës, heronjve dhe historisë së tyre dhe u pengon gjithçka që u flet për gjendjen reale të tyre njëjtë siç u pengonte udhëtarëve të anijes prej reje piktura e piktorit. Poezia është thirrje për vetëdijesim. Thirrje për kujtesë bëhet edhe përmes Pegasis, Fushave të Elizeut dhe Kadmit të parit mitik.

3. Pegasi - 177. Në poezinë **“Një fletëz ditari”** miti mbi Pegasin rimerret për të folur për legjendën mbi Pegasin shpëtimtar, të cilën e thurte plaka, në natën që zhvillohej me ankth në atdheun që nuk e merrte gjumi. Siç mund të kuptohet miti rimerret në kuptimin e shpëtimit që pritej me padurim në kohërat e vështira të një kombi. Thirrja është thirrje për kujtesë për kohërat e vështira, thirrje për t’u kujtuar e ruajtur historia. Në poezinë **“Tanusha”** Halili loz me kalin pegaz në Fushat e Elizeut të cilën lojë e vështron Tanusha nga veranda. Miti mbi Pegasin duke e shoqëruar me Halilin nga këngët kreshnike siç mund të kuptohet rimerret për të folur për lashtësinë e legjendës mbi Halilin, lashtësinë e tokës arbërore e cila ishte aty që nga koha kur tek popujt e lashtë gjallonte besimi mbi fushat e Elizeut.

4. Fushat e Elizeut - 178. Miti rimerret në veprën **“Mjedra dhe Bluz”** në poezinë **“Tanusha”**.¹⁷⁹ Miti mbi fushat e Elizeut të cilat i vështron Tanusha nga veranda e në zemër të tyre shih Halilin si lozte me kalin pegaz, siç mund ta kuptojmë rimerret për t’u dhënë karakter shqiptar këtyre fushave parajsore. Ato vendosen në toka shqiptare, në zemër të tyre loz një kreshnik shqiptar e kurse mbi krye kanë Tanushën e bukur. Për të thënë në një farë forme se këto fusha ishin aq të lashta sa Tanusha, sa lugjet e verdha, sa pegasi e kreshniku shqiptar dhe me doemos këtu duhej të kishin qenë, ose të paktën këtu kishin qenë sipas syrit të subjektit lirik.

Miti mbi Fushat e Elizeut rimerret edhe në poezinë **“Byron-i në mol”**. Në fushat e Elizeut në poezi, poeti e përcjell Markun, (Marko Boçarin), të cilin e quan vëlla të Ali luanit (Ali Pashë Tepelenës). Përmes kësaj pjese na jepet të kuptojmë origjinën e dy figurave që kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë shqiptare dhe atë Evropiane të epokës së Napoleon Bonapartës.

¹⁷⁶ Ahmeti, Lindita, *Mëshiteknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, fq. 73.

¹⁷⁷ Pegasi- kalë me fletë, që luan rol të madh në shumë legjenda. Ai lindi nga gjaku i Gorgonës Meduzë, që e vrau Perseu. Heroi e përdori atë në shumë ekspedita. Shpesh Pegasin e identifikonin me kalin që Poseidoni nxorri nga shkëmbi i Akropolit duke e goditur truallin me sfurkun e vet. Legjenda të tjera thonë se Pegasi ishte një kalë, të cilit i hipnin muzat ose Eoja. Si rezultat i lidhjeve me muzat, Pegasi u bë për poetët e kohës së re, simbol i frymëzimit poetik. (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq.192- 193).

¹⁷⁸ Fushat e Elizeut- pjesë e botës së përtejvarrit, ku sipas besimit të lashtë shkonin shpirtrat e njerëzve të drejtë. Sipas përfytyrimeve të grekëve të vjetër, aty banojnë heronjtë dhe njerëzit e virtytshëm pas vdekjes. Aty ata kalojnë jetën në lumturi të plotë, në harmoni e në paqe, në mes të festave, të valleve dhe të peizazheve të mahnitshme. (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 97).

¹⁷⁹ Ahmeti, Lindita, *Ishulli adular*, Shkupi, Shkup, 1996, fq. 54.

Përpos kësaj përcjellja e Markos (ortodoks) për në fushat e Elizeut na lë të kuptojmë edhe mbizotërimin e Islamit në këto hapësira si dhe mbizotërimin e sundimit osman mbi Shqipëri. Kështu si në poezinë e parë si në të dytën, shohim një rikujtim të bëmave historike të heronjve dhe rikujtim për prejardhjen dhe lashtësinë, për origjinën. I bëhet thirrje popullit të kujtojë dhe ruaj vlerat e veta, të mos i harrojë dhe mos ta braktisë historinë dhe sakrificën e paraardhësve të popullit, t'i kujtojë armiqtë dhe padrejtësitë që i ishin bërë.

5. Kadmi¹⁸⁰- Miti mbi Kadmin rimerret në disa vepra. Në veprën *“Ishulli adular”* miti mbi Kadmin rimerret në poezinë *“S’mund të vij me ty”*. Në këtë poezi subjekti lirik refuzon të shkojë me çunin syshkruar në skajet e botës, ajo dëshiron të rijë në atdhe atje ku mund t'i sheh gjurmët e Kadmit plak. Siç mund të kuptojmë miti mbi Kadmin rimerret për të na kujtuar për lashtësinë e Arbërisë por edhe për t'i hapur sytë e të gjithë atyre që mendojnë se mund ta shpëtojnë atdheun nga larg, që të shohin se ky vend ka nevojë të ndihmohet duke ndenjtur dhe duke kontribuar për të, duke ia bërë të mundur botës të sheh gjurmët e vjetra të Kadmit, historinë e shtrembëruar, të vërtetën dhe vlerat.

Në veprën *“Dhoma pa derën dalëse”* miti mbi Kadmin rimerret në poezinë *“Lindja e Lasgushit”*.¹⁸¹ Në poezi zanat ia tregojnë në vesh Lasgushit këngët më të bukura me të cilat ai do ta stolisë gjuhën e Kadmit. Pra, miti mbi Kadmin rimerret për të na kujtuar për lashtësinë e gjuhës shqipe. Duke iu referuar gjuhës shqipe si gjuhë e Kadmit, mbështetet teza e prejardhjes së shqipes nga ilirishtja. Në poezinë *“Prizreni”*¹⁸² Lorenc Antoni ngre si kala këngën shqipe për Prizrenin, qytetin e çunit të lirë dhe për çerdhen e amshueshme të shpirtit të dy gjarpërinjve të parë të themeleve të këtyre shtëpive që flasin shqip. Këtu miti mbi Kadmin e Harmoninë dy gjarpërinjtë- themeluesit e Ilirisë, Arbërisë rimerret siç mund të shihet rimerret për të na kujtuar dhe për të mbështetur origjinën dhe lashtësinë e Prizrenit, të banorëve të tij dhe të gjuhës shqipe.

Në veprën *“Mëshateknaja e babait”* e gjejmë te *“Shqipëria ime”*¹⁸³ ku ai dhe Harmonia na shfaqen si të parët mitik që rrojnë në një shtëpi të gurtë, në Shqipërinë e vendosur mes kepash si një trëndafilnajë. Të parët që shpikën lule e shpërndanë shkronja për librin e parë nga Sharri e Tomori, nga Bjeshkët e Nemuna. Që krijuan atë vend ku djemve u shkëlqejnë flokët e pruar dhe këngën e kanë si vazhdim i këngës së Linit, ku vashat e kanë zbuluar fronin e birit të diellit; atë vend i cili është muri kundër furtunës polare me arushën e tërbuar, atë vend që është djega e subjektit lirik. Siç mund të shihet miti rimerret që të shërbejë si kujtesë për lashtësinë dhe origjinën e Shqipërisë, gjuhës, këngëve dhe për bukuritë e veçantitë e vendit.

II. Harresa - Përveç kujtesës autorja me mitet që rimerr na tërheq vërejtjen edhe për harresën që ka pushtuar hapësirat e mendjeve tona dhe që na bën të ecim si në kllapi, pa u kujtuar për vlerën a identitetin tonë. Kjo do të arrihet duke rimarrë mitet mbi Oreadën, Odiseun dhe Muzën.

1. Oreada¹⁸⁴- Miti rimerret në veprën *“Mëshateknaja e babait”* në poezinë *“Oreadën e ndjekin personazhet e Olimpët”* ku atë ose subjektin lirik i pret Adonisi te burimi me duart plot yje, ku ajo ose subjekti lirik si valltare blerinash pranë kroit malor ecin solemnisht drejt burimit të rrethuar me lule iris illyrica, me shpirtin e mbushur plot vorbullë ndjenjash për çunin Adonis të cilët e ndjekin personazhet e Olimpët dhe zhduket pikërisht kur ajo ose subjekti lirik bëhen gati t'i hapin krahët për përqaftim.

¹⁸⁰ Shumë studiues e kanë quajtur hyjni pellazgjike. Ishte i biri i mbretit të Fenikisë Agenorit dhe vëllai i Evropës. Ai u martua me Harmoninë bijën e Aresit dhe Afërditës. Pasi pushtoi Ilirinë, u vendos aty së bashku me të shoqen. Djalit që lindi në këtë vend ia lanë emrin Ilir. Të dy bashkëshortët pas vdekjes u shndërruan në gjarpërinj dhe u pranuan pranë perëndive në fushat e Elizeut. (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq.128)

¹⁸¹ Ahmeti, Lindita, *Dhoma pa derën dalëse*, Logos A, Shkup, 2015, fq. 73.

¹⁸² Ahmeti, Lindita, *Dhoma pa derën dalëse*, Logos A, Shkup, 2015, fq. 115.

¹⁸³ Ahmeti, Lindita, *Mëshateknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015.

¹⁸⁴ Nimfat e maleve që e shoqëronin Artemidën në gjueti (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 181).

Oreada në këtë poezi nëse do ta shohim nga këndvështrimi personal simbolizon njeriun që nuk pajtohet me fatin e tij të trishtë, njeriun që jeton me peng në zemër, që humb dashurinë dhe shpresën. Kurse nëse do ta shohim nga këndvështrimi tjetër Oreada dhe subjekti lirik na paraqiten si pjesët e mbetura jashtë atdheut që nuk mund të pajtohen me fatin e tyre të. Përmes mitit mbi Oreadën, vihet në pah harresa që kishte mbuluar me pluhur padrejtësitë përgjatë historisë së kombeve dhe historisë së jetës së njerëzve.

2. Muza ⁻¹⁸⁵Miti mbi Muzën rimerret në veprën *“Ishulli adular”* në poezinë *“Elegji për atë që i ka mbetur vetëm fytyra e paqartë në kujtesën time”*. Në këtë poezi miti mbi muzën rimerret në kuptimin e frymëzimit. Ajo është e vetmja që i qëndron pranë subjektit lirik edhe atëherë kur e ndien që të gjitha i ka humbur. Edhe atëherë kur e ka kapluar pikëllimi, kur ballafaqohet me gënjeshtren. I jep frymëzimin për ta takuar shpresën në vargje. Përmes muzës që vjen si frymëzim flitet për harresën që i ka mbyllur çdo shteg, çdokujt për te subjekti lirik. Këtu harresa bëhet fatkeqësi e subjektit lirik dhe lidhet me aspektin personal më tepër se me atë kombëtar.

E kundërta ndodh në poezinë *“Dora e metaforës”*, në veprën *“Dhoma pa derën dalëse”*. Këtu muza kalon nëpër duar vargjet që janë shpresë për pak dritë në atë hapësirë që e ka mbuluar terri e mjerimi. Ajo sjell shpresë në botën plot pikëllim të subjektit lirik. Pikëllimi që vjen si pasojë e fikjes së gjuhës dhe vatrës, të cilat pamundësojnë që të dëshmohet për ekzistencën tonë, harresa e të cilave paraqet humbje të identitetit tonë dhe na bën të vetmuar, të humbur, të heshtur. Subjektit lirik i kanë mbetur vetëm vargjet që ia sjell muza, si mjete për ruajtjen e thelbit të vet, ruajtjen e shpresës për zgjim dhe mjete të ngadhënjimit përballë harresës.

3. Odiseu ⁻¹⁸⁶ - Miti mbi Odiseun rimerret në veprën *“Vetë përballë Erosit”* në poezinë *“Ngushticë”*¹⁸⁷ në këtë poezi siç mund të kuptohet miti rimerret për të folur për ishullin prej guri nëpër të cilin endet hija e tij. Ishulli prej guri mund të interpretohet si atdheu i subjektit lirik, i Naimit, Jeronimit, Ndreut. Arbëria e mbushur me fjalët e vjetra e të panjohura, për gjetjen e të cilave, muza t’i qet rrudhat palë-palë. Subjekti lirik kërkon çelësin e kohës dhe vendit ku gjuha është e re dhe ku liria e saj nuk pengohet në vargmale. Pra gjuhën e pastër burimore pa fjalë të huaja të panevojshme në të. Këtu ngrihet shqetësimi për harresën në kuptim të ri. U tërhiqet vërejtja njerëzve për harrimin e gjuhës së lashtë burimore shqipe, që kishte qenë gjuha e të urtëve, gjuha e vendit ku endej hija e Odiseut.

III. Tjetri - Krahas kujtesës dhe harresës, në krijimtarinë e Linditës rol të rëndësishëm luan edhe tjetri. Tjetri në krijimtarinë e Linditës është gjithnjë ai i ndryshmi nga populli i saj, ai që cenon lirinë tonë, individualitetin tonë, paqen tonë, kufijtë tanë individual, kombëtar a politik.

Në krijimtarinë e Linditës tjetri paraqitet përmes risemantizimit të disa miteve si për shembull: mitit mbi Panin, Niktën dhe Mojrën.

¹⁸⁵ Hyjnesha që, sipas Homerit, frymëzonin këngët. Ishin vajzat e Zeusit dhe Mnemozinës. Ato ishin nëntë dhe mbronin format e ndryshme të poezisë. Në kuptimin e figurshëm fjala muzë do të thotë frymëzim (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 170-171).

¹⁸⁶ Hero grek nga më të dëgjuarit e antikitetit. U martua me Penelopën me të cilën pati një djalë të vetëm Telemakun. Kur përgatitej fushata kundër Trojës ai u përpoq t’i bënte bisht dhe për të mashtruar të tjerët u shtir si i çmendur por më pas vendosi të merrte pjesë dhe u bë njëri nga iniciatorët më të zjarrtë të ekspeditës. Ai shkoi në Lemnos për të kërkuar Filokletin që kishte armët e Herakliut. Odiseu u fut në kalin prej druri dhe ndihmoi shumë në marrjen e Trojës. Homeri na tregon në “Odisea” kthimin e gjatë e plot peripeci për në Itakë dhe aventurat që herroi duhej të përballonte. Më në fund ai ia doli të kthehet në Itakë pas një mundimi prej 20 vjetësh. (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 179).

¹⁸⁷ Ahmeti, Lindita, *Vetë përballë Erosit*, Brezi 9, Tetovë, 2004, fq. 56.

1. Pani¹⁸⁸ Miti mbi Panin rimerret në shumë poezi në të gjithë krijimtarinë e Lindita Ahmetit. Në veprën *“Mjedra dhe bluz”* në poezinë *“Rilindja e Zonjës Plakë”* miti mbi Panin rimerret për të folur për panikun dhe tmerrin që armiku përhapte nëpër fshatrat që ai pushtonte. Në veprën *“Ishulli adular”* në poezinë *“Rrethi”* miti mbi Panin rimerret për të krahasuar shkronjat e huaja me britmat e tij. Subjekti lirik rreket të gjejë dëshmitë për lashtësinë e gjuhës dhe kombit megjithëse mungojnë dokumentet e shkruara nga kohërat e lashta. Në veprën *“Vetë përballë Erosit”* miti mbi Panin rimerret në poezinë *“Shtëpia e verdhë”*.

Në këtë poezi armiqhtë – fqinjët e Arbërisë, që sulmojnë nga të gjitha anët (vendin, gjuhën, kulturën) krahasohen me Panin. Ata i sjellin shkatërrim e tmerr vendit pa pasur fare mëshirë për tokën e sulmuar me shekuj, për popullin e saj të lodhur nga luftërat. Siç mund të kuptohet Pani është gjithnjë tjetri- i ndryshmi nga ne, ai që kërkon të fshijë gjurmët tona, që kërcënon identitetin tonë, që cenon shpresën tonë, territorin tonë, kulturën tonë; ai që ngrihet kundër bërthamës tonë, gjuhës, të cilën e mbush me britma e fjalë të pavlera, ai që tenton të lë gjurmët e veta tek ne me çdo kusht.

2. Nikta -¹⁸⁹ Miti mbi Niktën rimerret në veprën *“Ishulli adular”* në poezinë *“Nikta”*. Në këtë poezi miti mbi Niktën rimerret për të personifikuar me të armikun. Nikta në poezi njësoj si armiku i kombit, vjen me rropamë e i nxit njerëzit e paditur të vajtojnë për hapjen e shkollave si shenjë shturjeje, i nxit njerëzit të harrojnë, gjuhën, kombësinë, kulturën e tyre. Shembuj të armiqve të tillë i kemi parë shpesh te populli shqiptar.

Miti mbi Niktën rimerret edhe në veprën *“Lulja Alba”* në poezinë *“Diç si e drunjte”*.¹⁹⁰ Edhe në këtë poezi miti mbi Niktën rimerret si personifikim i armikut që sjell errësirën në trojet shqiptare. Në poezi Apoloni bëhet gati t’ia dorëzojë çelësat Niktës së nervozuar e burrat e fortë rrinë mbi rrenë e kuqe, i thithin nargjiletë, pinë duhan e pinë kafe. Subjektin lirik e shqetëson moskokëçarja, avashllëku e pasiviteti i shqiptarëve të cilët nuk arrijnë ta shohin armikun që vjen me një plan të parapërgatitur për t’i shkatërruar. Atë e habit mosndërmarrja e ndonjë veprimi që ta parandalojnë apo ta luftojnë ardhjen e tjetrit, kësaj të keqeje me pasoja fatale.

Në veprën *“Dhoma pa derën dalëse”* ky mit rimerret në poezinë *“Gjurmët”*. Miti rimerret për të folur për tjetrin, atë që mendohej të vjedh të kaluarën e huaj, skulpturat romake- pra figurat historike- mitologjike romake, ikonat e Bizantit e fjalët e objektet nga koha e pushtimeve turke. Me të tillët siç thuhet as Nikta (që kishte lindur gënjeshtren, hipnosin, tanatosin) nuk e pranonte aleancën. Të tillëve dita ua nxirrte gjurmët në shuplakë. Të tilla përpjekje sipas subjektit lirik siç mund të kuptohet janë boshe sepse njeriu kur nuk mund të strehohet përgjithmonë nën një kënd të strehës së huaj.

E as kush nuk mund të pretendojë të krijojë një komb me histori e kulturë të huaj. Në veprën *“Mështeknaja e babait”* në poezinë *“Tregimi i zi”*¹⁹¹ Nikta shfaqet duke marshuar kryelartë mbi gjallërinë bleroshe duke pamundësuar që të dëgjohet kënga e linit ndër lule dhe

¹⁸⁸ Perëndi arkaikë e pyjeve, e barinjve, e kopeve dhe e gjahtarëve. Ishte biri i Hermesit dhe i vajzës së nimfës Driopë. Ai ishte aq i shëmtuar kur lindi me brirë, këmbë, mjekër si të cjamin saqë e ëma e tmerruar e braktisi. I ati, Hermes i mori në duar dhe e dërgoi në Olimp. Ai banonte në pyje, duke preferuar vendet e vetmuara. Me shfaqjen e tij të papritur dhe me britmën e tmerrshme që nxirrte në orët e qeta të mesditës, ai iu kallte tmerrin të gjithë atyre që ia prishnin qetësinë e që këtej e ka burimin fjala panik. Në moshë të re ai ndiqte, Siringën, pas së cilës u dashurua. Por në çastin kur ishte duke e arritur, hyjneshat, të prekura nga tmerrin e saj, e shndërruan nimfën në kallam nga i cili Pani bëri fyellin e tij. Sipas priftërinjve të krishterë me vdekjen e Panit vdiq edhe periudha e paganizmit që u zëvendësua nga krishterimi. Në kuptimin e figurshëm shprehja “Vdiq Pani i madh” nënkuptonte jo vetëm vdekjen e një njeriu të shquar por edhe përfundimin e një epoke të caktuar Historike (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 188).

¹⁸⁹ (gr. natyra), hyjneshë që personifikon errësirën. Sipas Hesiodit, ishte bija e Kaosit, që u bashkua me vëllanë e saj, Erebin, dhe u bë nëna e Eterit dhe e Hemerës. Por ajo lindi edhe hyjni tjera si Tanatosi, Hiposin, Gënjeshtren, Pleqërisë, Ëndrren, Hidhërimin, etj. (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq.176).

¹⁹⁰ Ahmeti, Lindita, *Lulja alba* (përzgjedhje), Toena, Tiranë, 2008, fq. 216.

¹⁹¹ Ahmeti, Lindita, *Mështeknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, fq. 56.

të mos duket buzëqeshja e Aurorës që i mundësonte subjektit lirik t'i heqë prangat e zisë dhe karriges së gurtë që e mbajnë lidhur në atë pyll ku fryn nga pesë anë të tregimit të zi.

Nikta në poezi arrin që ta shuaj këngën e Linit dhe i pamundëson njerëzve që të dalin nga terri dhe zia duke mos iu lënë aspak shpresë për të parë dritë. Nikta merr rolin e tjetrit (armikut) që zhdukte mësuesit si Lini dhe i pamundësonte brezave të ardhshëm të ndriçoheshin nga fjala e mësuesit – nga drita e diturisë. Siç mund të kuptohet në të gjitha rastet kur autorja rimerr mitin mbi Niktën ajo na vendos përballë tjetrit, armikut tonë keqdashësit tonë dhe na njofton me atë që nuk arrijmë ta shquajmë në veprimet e tjetrit, na shpalos qëllimet e tjetrit, na afron me veten, vlerat dhe dobësitë tona, na bën të kuptojmë që duke kuptuar tjetrin dhe qëllimet e tij do të kuptojmë qëndrimin që duhet të mbajmë përballë tjetrit.

Tjetri në krijimtarinë e Lindita Ahmetit portretizohet edhe përmes Mojrave.

3. Mojrata -¹⁹² Miti mbi Mojrata rimerret në veprën *“Brezi i Zonjës”* në poezinë *“Ëndrra po më fiket”*. Në këtë poezi subjektit lirik ia kanë humbur shpresën, të gjithë ata që Panin-vuajtjen dhe shkatërrimin sillnin, madje as shenjat e mojrave- fatit (shpresës për ditë të mira) nuk i kanë lënë të duken. Siç mund të kuptohet rimartja e figurës së Mojrave në këtë poezi, konkretisht pamundësia për të gjetur as gjurmët e tyre ndihmon në specifikimin e tragjizmit dhe dëshpërimit që përjeton subjekti lirik.

Në veprën *“Mështeknaja e babait”* mitin mbi Mojrata e gjejmë në poezinë *“Anija e varur prej reje”*¹⁹³. Këtu e gjejmë Atropën flokëshprishur që i afrohet me gërshërën e saj të madhe perit të kuq në të cilin ri varur anija prej reje, ku qëndrojnë të rinj e pleq pa u trazuar aspak për fatin e tyre, pa u shqetësuar për të këqijat që u vijnë për të nesërmen, që Atropën e kanë aq afër që Hermes i ka hapur krahët për t'i shoqëruar te dyert e Persefonës, që piktorit ia pshurrin pikturën dhe s'bëhen vrer fare për bujqit e huaj që me shpojca të gjata hapin vazhdimisht vrima në murin e bardhë të altarit ku rruhet rrënja e artë.

Pra në këtë poezi rimerret miti mbi Mojrata Antropë. Miti rimerret për të treguar se këta udhëtarë moskokëçarës i priste fundi - shqiptarët moskokëçarës, të cilët as që shqetësoheshin për të huajt që iu ndërhyenin në gjuhë, si bujqit e huaj të poezisë që shpojnë murin ku rruhet rrënja e artë, pra gjuha; që lejonin dikush ta prek të vetmin mjet që i mbante gjallë si komb, të vetmen provë të sigurt të lashtësisë, historisë, kulturës e prejardhjes së tyre. Këto banorë që s'i përfillin aspak ata që i paralajmërojnë për këtë rrezik, si piktorin e pikturën e tij. Këta banorë moskokëçarës që i mbyllin sytë edhe para realitetit, edhe para rrezikut, edhe para fundit të tyre.

Në dy rastet që kemi marrë për ta ilustruar tjetrin të paraqitur përmes risemantizimit të mitit mbi Mojrata, siç mund të shihet autorja mban qëndrime të ndryshme në dy rastet. Në rastin e parë ajo na ballafaqon me mllefin ndaj tjetrit, të pamëshirshmit që zhduk çdo gjë dhe s'le as shpresë pas kur largohet, kurse në rastin e dytë, na ballafaqon me mllefin ndaj qëndrimit tonë përballë tjetrit, paralizës tonë përpara tjetrit, moskokëçarjes sonë dhe rreziqeve që na kanosen nga një gjendje e tillë.

Për të folur për këto tema të ndjeshme siç mund ta shohim autorja përdor figura të Zotave antik grekë. Ajo sheh te këta zota një pasqyrë të shpirtit tonë, nuk i sheh si figura të jashtme por si simbole të diçkaje të brendshme që e karakterizon qenien tonë. Për autoren vlen koncepti i Jungut mbi zotin dhe moralin i cili thotë: *Nëse për shembull, unë përdor konceptin Zot ose një tjetër koncept metafizik energjie, e bëj këtë ngaqë këto figura kanë qenë në mendjen njerëzore prej fillimit. Mendoj se duhet të theksoj përsëri e përsëri që as rendi moral, as ideja e Zotit as*

¹⁹² Hyjnesha motra të fatit të njeriut, bijat e Zeusit dhe Temidës. Ato ishin tri: Klotoja, Lakesida dhe Atropoja. Fati sundonte mbi të vdekshmit dhe perënditë. Moirat i përfytyronin si tri gra të zbehta e të dobëta, që nën dritën e një lllambe endnin në heshtje fatin e njeriut. Klotoja më e vogla e mbante furkën në dorë dhe endte fijen e jetës duke përcaktuar kohën dhe afatin e jetës së tij. Lakesida e kalonte atë përmes të gjitha trilleve të fatit, kurse Atropoja më e madhja, priste pa u epur me gërshërët e saj fatale fijen e jetës së njeriut. (Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 169-170).

¹⁹³ Ahmeti, Lindita, *Mështeknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015, fq. 73.

*ndonjë fe, nuk ka rënë në prehër të njeriut nga jashtë, drejt prej qiellit, po ky i ka pasur të gjitha këto in nuncë (qysh në embrion, përkth.) brenda vetes dhe, për këtë arsye mund t'i prodhojë jashtë vetes. Prandaj është një përtaci të mendosh se asgjë tjetër përveç ndriçimit nuk nevojitet për t'i larguar këto fantazma. Idetë e rendit moral dhe të Zotit i përkasin substratit të paçrrenjosshëm të shpirtit njerëzor.*¹⁹⁴ Duke u nisur nga kjo ide më mirë mund ta kuptojmë se si ja del autorja të risemantizojë mitet dhe t'i përdor ato për të krijuar prej tyre simbole të reja për një kulturë, kohë dhe problematikë të dhënë.

Përfundimi

Nga analiza e bërë mund të vijmë në përfundim që përmes risemantizimit të disa miteve të caktuara autorja na jep një pasqyrë interesante për kujtesën, harresën dhe tjetrin në përditshmërinë dhe kulturën shqipe. Ajo i qaset me seriozitet nevojës për t'u trajtuar si çështje raporti ynë me këto tre elemente dhe përmes forcës së vargut të vet na vetëdijëson për rëndësinë dhe rolin e tyre në jetën, kulturën dhe historinë tonë kombëtare. Autorja na porosit se çfarë qëndrimi duhet të mbajmë në raport me kujtesën, harresën dhe tjetrin duke na folur për pasojat që sjell neglizhenca dhe mosveprimi.

Duke i analizuar vargjet e Lindita Ahmetit kuptojmë që harresa, e gjuhës, kulturës dhe së kaluarës sjell zhbërjen e identitetit kulturor. Kuptojmë që tjetri është ai që na nxit drejt harresës, ai është si Pani që tenton t'i fshijë gjurmët tona dhe ta mbushë me britma gjuhën tonë. Kuptojmë që kujtesa dhe ruajtja me xhelozë e gjuhës, kulturës dhe historisë sonë është në fakt ajo që na ruan nga asimilimi, ajo që ruan bërthamën tonë, gjuhën tonë, identitetin tonë. Prandaj, këto elemente meritojnë vëmendje, seriozitet dhe studime edhe më të gjera të cilat urojmë që t'i nxisë ky punim.

Referencat

- [1]. Eliade, Mircea, *Miti dhe realiteti*, Pika pa sipërfaqe, Tiranë, 2019.
- [2]. Dhama Todi, *Fjalor i mitologjisë*, Rilindja, Prishtinë, 1988.
- [3]. Jung, Carl, *Ëndrrat*, Dritan, Tiranë, 2003.
- [4]. Ahmeti, Lindita, *Mështeknaja e babait*, Portalb, Shkup, 2015.
- [5]. Ahmeti, Lindita, *Ishulli adular*, Shkupi, Shkup, 1996.
- [6]. Ahmeti, Lindita, *Dhoma pa derën dalëse*, Logos A, Shkup, 2015.
- [7]. Ahmeti, Lindita, *Vetë përballë Erosit*, Brezi 9, Tetovë, 2004.
- [8]. Ahmeti, Lindita, *Lulja alba* (përzgjedhje), Toena, Tiranë, 2008.

¹⁹⁴ Jung, Carl, *Ëndrrat*, Dritan, Tiranë, 2003, fq. 77.